



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Priljeno / Prodato Received / Delivery	17.01.2022	3	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot. No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHCK	438/2023		1/5



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1053/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Flakron Gashi - Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1053/2022 të datës 24.11.2022, të parashtruar nga \_\_\_\_\_ nga Gjakova, kundër organit të punësimit Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, në çështjen juridike "Kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 16.01.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.1053/2022 e datës 24.11.2022, e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vendimi KA.Nr.32/2022 i datës 31.10.2022, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Arsyetim

Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës (tutje referuar si SKPK), më datën 22.08.2022 ka shpallur konkurs të jashtëm për pozitën e punës Zyrtar për Transport 3, në Prokurorinë Themelore në Gjakovë, i cili konkurs sipas shkresave të lëndës ishte i hapur për aplikim nga data 22.08.2022 deri me datën 05.09.2022.

Në listën e ngushtë të datës 12.09.2022 të publikuar nga SKPK janë përfshirë vetëm tre (3) kandidatë, ndër ta edhe ankuesi i cili ka marrë pjesë në të gjitha fazat e procedurës së rekrutimit lidhur me pozitën përkatëse të punës, ndërsa sipas Njoftimit për përzgjedhje përfundimtare të datës 20.09.2022 si kandidat i suksesshëm lidhur me këtë pozitë të punës është shpallur Dukagjin Haxhiu me gjithsejtë 87.1 pikë.

Ankuesi i pa kënaqur me vendimin për përzgjedhjen përfundimtare, me datën 20.10.2022 parashtron ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të SKPK-së, me pretendimet ankimore për shkelje procedurale, shkelje të rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, ndërsa ky i fundit përmes Vendimit KA.Nr.32/2022 të datës 31.10.2022 refuzon si të pa bazuar ankesën e ankuesit të datës 20.10.2022, duke lënë në fuqi Njoftimin e datës 20.09.2022 lidhur me kandidatin e suksesshëm të lëshuar nga Divizioni i Burimeve Njerëzore në SKPK.

Kundër Vendimit me numër KA.Nr.32/2022 të datës 31.10.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të SKKK-së, ankuesi brenda afatit ligjor me datën 24.11.2022 parashtron ankesë me numër të protokollit 7371/2022 të regjistruar nën shenjen A.nr.1053/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të ligjit material.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datën 29.11.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek SKPK, ndërsa më datën 13.12.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit, bazuar në dispozitat e nenit 17 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 28.12.2022 me Vendimin VK.nr.201/2022 ka vazhduar afatin për vendimmarrje edhe për 10 ditë pune lidhur me ankesën A.nr.1053/2022 e datës 24.11.2022, e parashtruar nga ankuesi Dardan Kokalla.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave* pas konstatimit se ankesa është e pranueshme sipas nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike dhe për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër të protokollit 7371/2022 të regjistruar nën shenjen A.nr.1053/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër 1810/2022 të datës 31.10.2022 të KZKA-së; E-mailin zyrtar të datës 24.11.2022; Autorizimin me numër 63/2020 të datës 09.09.2020 nga Prokuroria Themelore Gjakovë; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokollit 7452/2022 të datës 29.11.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në kërkesë me numër protokollit 7965/2022 të datës 13.12.2022 nga SKPK; Konkursin e datës 15.02.2022; Vendimin me numër 1510/2022 të datës 08.09.2022; Vendimin me numër 1495/2022 të datës 06.09.2022; Regjistri i aplikacioneve të pranura të datës 09.09.2022; Njoftimi i kandidatëve të përzgjedhur në listën e ngushtë të datës 12.09.2022; Deklaratën për mosekzistim të konfliktit të interesit të datës 14.09.2022; Testin me shkrim të kandidatit \_\_\_\_\_ u të datës 14.09.2022; Deklaratën për mosekzistim të konfliktit të interesit të datës 14.09.2022; Testin me shkrim të kandidatit \_\_\_\_\_ të datës 14.09.2022; Deklaratën për mosekzistim të konfliktit të interesit të datës 14.09.2022; Testin me shkrim të kandidatit \_\_\_\_\_ të datës 14.09.2022; Përmbledhjen e vlerësimeve individuale të testit me shkrim të datës 14.09.2022; Çelësin e testit me shkrim të datës 14.09.2022; Formularin e Vlerësimit Individual në Intervistë me gojë të datës 16.09.2022; Formularin e vlerësimit individual në intervistë me gojë të datës 16.09.2022; Formularin e vlerësimit individual në intervistë me gojë të datës 16.09.2022; Formularin e vlerësimit individual në intervistë me gojë të datës 16.09.2022; Përmbledhje e vlerësimeve individuale e



intervistës të datës 16.09.2022; Dëshmin për dorëzimin e aplikacionit me numër 1473 të datës 07.9.2022 të kandidati . Aplikacion për punësim të datës 02.09.2022 të kandidatit Diplomë me numër protokollit 563 të datës 07.06.2008 të ; Letër Referencë të datës 02.09.2022 për . Kopje e Patentë Shoferit të Kopje e letërnjoftimit të ; Dëshmi për dorëzimin e aplikacionit të datës 25.08.22 të kandidatit Aplikacion i kandidatit të datës 24.08.2022 së bashku me dëshminë mbi përgatitjen profesionale dhe atë të punës, formularët e vlerësimit; Kopjen e letërnjoftimit dhe certifikatën nga gjykata; Dëshmi për dorëzimin e aplikacionit me numër 962 të datës 30.08.200 të kandidatit ; Aplikacionin e kandidatit datës 30.08.2022 së bashku me dëshminë mbi përgatitjen profesionale dhe atë të punës; Kopjen e letërnjoftimit; Kopjen e patentë shoferit, dhe certifikatën nga gjykata; Ankesën me numër protokollit 1743 të datës 20.10.2022 nga ankuesi ; Vendimin me numër 1810/2022 të datës 31.10.2022 nga Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, si dhe Vendimin me numër VK.nr.201/2022 të datës 28.12.2022 të Këshillit për vazhdimin e afatit të ankesës së ankuesit.

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresat të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit është e pa bazuar, sepse:

Ankuesi në ankesën e parashtruar me datë 24.11.2022 pretendon se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave nuk ka vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike dhe gabimisht ka zbatuar ligjin material, ngase sipas të njëjtit kandidatët për testimin me shkrim dhe intervistë me gojë në këtë procedurë janë njoftuar vetëm përmes telefonit e jo përmes e-mail adresës, i njëjti thekson se nuk janë prezantuar pikët e kandidatëve, po ashtu deklaroi se përbërja e Komisionit Përzgjedhës, e sidomos kryetari i këtij komisioni ka krijuar anshmëri në vlerësim dhe hakmarrje me arsyetimin se kandidati fitues ka raporte të mira shoqërore dhe familjare me këtë të fundit, gjithashtu thekson se përbërja e komisionit është në kundërshtim me nenin 9 të Rregullores Nr.02/2010 për faktin se me kryetarin e këtij komisioni nuk ka raporte të mira shoqërore dhe është dashur të bëhet përjashtimi i tij pasi që nuk i është dhënë mundësia të paraqesë kërkesë për përjashtim të këtij të fundit dhe se kandidati fitues nuk e ka përvojën e punës.

Kolegji i Këshillit nga shqyrtimi i shkresave të lëndës ka gjetur se konkursin e shpallur për pozitën e punës *Zyrtar për Transport 3*, në Prokurorinë Themelore në Gjakovë, si kriteret themelore të përcaktuar kanë qenë: Përgatitja profesionale dhe kualifikimi: *Shkolla e mesme, Patentë shoferi kategoria B*, Përvoja e punës: *Së paku 3 vite përvojë pune*. Rrjedhimisht, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës është konstatuar se kandidati i përzgjedhur ka plotësuar kriteret e konkursit, ngase Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se kandidati i përzgjedhur me rastin e aplikimit si dëshmi ka dorëzuar: Diplomën me numër rendor të regjistrimit 27 si dhe me numër të protokollit 14.1988 të datës 18.06.1988 sipas së cilës dëshmohet se i njëjti ka përfunduar Shkollën e Mesme në Q.M.N "Hajdar Dushi" në Gjakovë. Patentë shoferin e datës 12.03.2020 të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme. Ndërsa lidhur me dëshminë e përvojës së punës i njëjti ka dorëzuar Kontratën e Punës me Swisscontact, të datës 09.05.2001; 04.02.2004; 30.06.2004; 17.12.2004; Kontratën e Punës me SH.P.K Vegros me seli në Prishtinë, të datës 01.05.2007; 01.07.2008. Kontratën e Punës me Birra Peja Sh.A, të datës 01.12.2010; 02.04.2014; 05.01.2015; 09.03.2015; 09.06.2015, kështu që Kolegji i Këshillit vlerëson se i njëjti ka plotësuar kriteret e konkursit dhe Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil me rastin hartimit të listës së shkurtër ka vepruar në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil (i aplikueshëm për SKPK) përkatësisht nenin 28 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1



dhe 1.2 ku përcaktohet se: 1. Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kritereve në vijmë: 1.1 Arsimimi dhe kualifikimi profesional; si dhe 1.2. përvoja e punës, ndërsa pretendimi ankimor i ankuesit mbi këtë bazë është i paqëndrueshëm.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se është njoftuar vetëm përmes telefonit lidhur me mbajtjen e testimit me shkrim dhe intervistës me gojë, Kolegji i Këshillit nga analizimi i nenit 31 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, vlerëson si esenciale njoftimin e kandidatëve në çdo fazë të procedurës, për çka ankuesi nuk e konteston një gjë të tillë, ndërsa mënyra e njoftimit në rrethanat e rastit konkret kur dihet se ankuesi i është nënshtruar të gjitha fazave të rekrutimit nuk është relevante dhe se pretendimi ankimor si i tillë është i pa bazuar.

Kolegji i Këshillit bazuar në provat e lëndës, respektivisht formularin e përmbledhjes së vlerësimeve individuale të testit me shkrim dhe intervistës me gojë ka gjetur se kandidati i përzgjedhur në testin me shkrim dhe intervistën me gojë ka mbledhur gjithsejtë 87.1 pikë ndërsa ankuesi në testin me shkrim dhe intervistën me gojë ka mbledhur gjithsejtë 61.2 pikë nga rrjedh se kandidati i përzgjedhur ka arritur me se shumti pike duke u renditur si kandidati me si suksesshëm. Rrjedhimisht, nga shqyrtimi i çelësit të testit me shkrim është konstatuar se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil, ka vepruar në pajtim me nenin 37, 38 dhe 39 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe nuk është vërejtur ndonjë shkelje procedurale ngase të gjithë kandidatëve i është dhënë mundësia e barabartë për t'iu nënshtruar të gjitha procedurave ligjore, në këtë rast Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, andaj pretendimi ankimor i ankuesit në këtë kuptim është i pabazuar.

Sa i përket pretendimit ankimor të ankuesit se me kryetarin e komisionit përzgjedhës nuk ka pasur raporte të mira dhe se i njëjti ka qenë i njëanshëm ndaj tij dhe hakmarrës si dhe ka favorizuar kandidatin e suksesshëm, Kolegji i Këshillit analizoj shkresat e lëndës si pjesë përbërëse të kësaj procedure të rekrutimit mirëpo nuk gjeti ndonjë provë që mbështet pretendimin e ankuesit, nga fakti se ankuesi gjatë procesit të rekrutimit nuk ka dorëzuar ndonjë kërkesë për përjashtim të ndonjërit nga anëtarët e Komisionit Përzgjedhës, në kuptim të nenit 30 paragrafi 3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që pretendimi ankimor si i tillë është i pabazuar.

Rrjedhimisht, Kolegji i Këshillit vlerëson se Komisioni për Zgjidhen e Kontesteve dhe Ankesave në SKPK, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër KA.Nr.32/2022 të datës 31.10.2022 ka vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike dhe po ashtu drejtë ka zbatuar ligjin material, duke vepruar kështu në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, për sa me sipër dhe duke u mbështetur në dispozitat e nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafin 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente/Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda: A.nr.1053/2022**

**Flakron Gashi**

Procesmbajtëse



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.